

**VLERËSIM PARAPRAK I
SHËRBIMEVE TË BASHKISË
KORÇË PËR MINORITETIN ROM
DHE KOMUNITETIN EGJIPTIAN**

Korçë, 21 Shkurt 2013

Edlira Papavangjeli

Menaxhere e Programeve

Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Kuadri ligjor

Shqipëria mund të konsiderohet si një nga vendet që ka një kuadër të plotë ligjor në fushën e të drejtave të njeriut sepse:

- *ka ratifikuar Konventa të rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut*
- *ka miratuar një seri kodesh dhe ligjesh për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të minoriteteve*

Politikat publike

- Strategjia e Qeverisë Shqiptare për përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit Rom (2005-2015)
- Strategjia e përfshirjes sociale 2007-2013
- Strategjia Sektoriale e mbrojtjes sociale 2007-2013
- Plani i veprimit për Dekadën Rome (2009-2015)

Metodologjia

Qëllimi: analiza dhe vlerësimi i planeve, politikave dhe veprimeve konkrete në nivel vendor në lidhje me shërbimet sociale dhe strehimin për komunitetin Rom dhe Egjiptian


Objektivat:

- Vjelja e opinionit të dy komuniteteve në nevojë për çështje të strehimit dhe kushteve të banimit
- Evidentimi i politikave dhe veprime konkrete të zbatuara nga bashkia për kushtet e banimit dhe strehimit
- Monitorimi i mbulimit, nivelit dhe aksesit në shërbime sociale
- Të ndihmonte për të orientuar programet dhe projektet drejt nevojave të këtyre komuniteteve.

Metodologjia


- Intervistat gjysmë të strukturuar
- Pyetësorët me komunitetin
- Kërkimi në internet
- Periudha Dhjetor 2012 - Shkurt 2013

Regjistrimi në gjendjen civile (n=29)




Nuk rezultojnë probleme të thella të regjistrimit në gjendjen civile me minoritetin Rom.

Karakteristika të tjera (n=30)



Vetëm 7% e të intervistuarve përfitojnë nga programi i ndihmës ekonomike. Asnjë nga familjet nuk merr përfitime nga programe që mbështesin grupet në nevojë


Pjesëmarrja në tregun e punës (n=30)



Pjesëmarrja në tregun e punës është shumë e ulët për të dyja komunitetet


Sektori i punësimit (n=7)

■ Tregti ■ Pune te rastit ■ Tjeter




Rreth 57% e të anketuarve janë të punësuar në sektorin e tregtisë, ndërkohë që pjesa tjetër në punë të rastit apo punë të tjera

Punësimi vs. mosha (n=30)



Papunësia është e lartë në të gjitha grup moshat dhe për të dy komunitetet


Të ardhurat mujore (n=7)



Familjet rome kanë të ardhura më të ulëta se familjet egjiptiane


Vendosja në vendbanim (n=30)

■ Perpara '90 ■ Mbas '92




60% e të anketuarve janë vendosur në bashkinë e Korcës përpara vitit 1990

Zotërimi i një banese (n=30)




Personat që nuk zotërojnë banesë (40%) janë vendosur në këtë bashki pas vitit 1992.

Sipërfaqe banimi vs. nr personash (n=18)




Rreth 22% e familjeve që zotërojnë një banesë nuk kanë sipërfaqe të mjaftueshme për frymë.

Regjistruar si të pastrehë (n=12)




63% e të intervistuarve janë regjistruar si të pastrehë. Përqindjen më të madhe e zë komuniteti egjiptian me afro 83%.

Rezultate të tjera (n=30)




Minoriteti Rom dhe komuniteti Egjiptian nuk ka probleme me furnizimin me energji elektrike. Komuniteti ka qendra shëndetësore në afërsi të qendrës së banimit dhe të gjithë të intervistuarit kanë pohuar që i paguajnë taksat vendore.

Rezultate të tjera (n=19)



Megjithëse janë regjistruar si të pastreha rreth 63% e familjeve të intervistuar vetëm 5% e tyre pohojnë që kërkesa iu është marrë në konsideratë nga bashkia. Ndërkohë që numri i të anketuarve që kanë informacion për përfitimin e banesave sociale është 68%.

Ndihma ekonomike vs. mosha (n=30)



Vetëm 2 nga 30 personat e intervistuar e përfitojnë ndihmën ekonomike

Gjetjet nga pyetëtori me stafin e Bashkisë

- Bashkia ka identifikuar plotësisht nevojat për strehim dhe ka hartuar program afatmesëm për plotësimin e tyre.
- Në numrin e përgjithshëm të të pastrehëve komuniteti Rom dhe Egjiptianë zë 15-20%. Numri i kërkesave nga ky komunitet për përfitimin e banesave sociale është më shumë se 60.
- Strehimi i tyre mund të bëhet në dy mënyra: në ndërtesa të veçuara ose në ndërtesa së bashku me banorë të tjerë.
- Bashkia ka parashikuar lehtësira për strehimin e këtij komuniteti.
- Bashkia ka planifikuar fonde për përmirësimin e kushteve të strehimit/banimit për këto komuniteteve (në fushën e infrastrukturës, strehimit dhe furnizimit me ujë të pijshëm).

Gjetjet nga intervistat

- Sipas specialistëve numri i familjeve rome që marrin ndihmë ekonomike mund të jetë afërsisht 15% dhe së bashku me familjet egjiptiane mund të jenë më pak se 50%.
- Administratorët e rajoneve ofrojnë asistencën e tyre për të gjitha familjet në nevojë dhe lehtësojnë plotësimin e procedurave.
- Në territorin e bashkisë Korçë ushtrojnë veprimtarinë e tyre disa qendra të shërbimeve sociale si: qendra publike për fëmijët jetimë (me 17 fëmijë) dhe dy qendra jopublike (me 24 fëmijë).
- Në bashki ka të dhëna në lidhje me numrin e përfituesve nga qendrat e shërbimeve sociale.

Gjetjet nga intervistat

- Bashkia Korçë ka qendra të shërbimeve sociale
- Për PAK ka 3 qendra publike ku marrin shërbim 146 persona, nga të cilët vetëm 1 është i identifikuar si Romë. Gjithashtu, ka 3 qendra jopublike që japin shërbime për 742 persona nga të cilët 609 marrin shërbim në shtëpi, 47 janë paraplegjikë dhe iu shërbehet 83 personave me kancer (3 janë Romë)
- Stafi i bashkisë jep kontribut për hartimin e raport progresit për zbatimin e PVD.
- Specialistët që merren me grupet në nevojë nuk japin ndonjë kontribut konkret në hartimin e buxhetit të bashkisë.
- STR duhet të mbështesë me më shumë asistencë bashkitë për zbatimin e PVD dhe të asistojë bashkinë për hartimin e një plan veprimi konkret në përputhje me nevojat e këtij komuniteti në Korçë.
- Bashkia ka të dhëna sidomos për problemet e strehimit dhe ato përdoren për qëllime të ndryshme.

Pyetje – Diskutime-Rekomandime

- Çfarë duhet të bëhet ndryshe?
- Cilat janë sfidat që ka Bashkia në fushën e strehimit dhe infrastrukturës?
- Çfarë mund të bëhet për të rritur numrin e përfituesve në qendrat publike dhe jopublike të shërbimeve sociale?

Faleminderit!